



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 598 prot.

Tiranë, më 15. 05. 2023

V E N D I M

Nr. 70, datë 15. 05. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. nr. 173, datë 11.11.2022, e D. T., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar pretendimeve të parashtruara në ankesë, rezulton se në bazë të shpalljes nr. 1319 prot., datë 29.09.2022, të publikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, në datën 06.10.2022, ankuesi D. T. ka aplikuar për një nga pozicionet vakante për oficer të policisë gjyqësore pranë seksioneve të prokurorive të shkallës së parë. Ankuesi ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master Profesional¹ në të Drejtën Penale në Fakultetin e Shkencave Humane, pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Duke u mbështetur në kriterin e përcaktuar në pikën 3, të shpalljes në fjalë, ku citohet: “Aplikantët që do të shprehin interes duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtëm:c) kopjen e diplomës dhe listës së notave të arsimit të lartë dhe çdo dokument që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”, ankuesi ka gjykuar se i plotëson kriteret arsimore për oficer të policisë gjyqësore dhe ka depozituar dokumentacionin e tij pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Në vijim, D. T. shprehet se pasi ka kaluar një periudhë e konsiderueshme kohe pa patur asnjë informacion nëse është kualifikuar për fazën pasardhëse të konkurimit, ka kërkuar informacion me e-mail nga Prokuroria e Përgjithshme. Ky institucion e ka njoftuar ankuesin se është skualifikuar, pasi nuk ka përmbushur kriterin e Masterit të Shkencave, kriter, i cili sipas ankuesit nuk rezulton i cituar në asnjë pikë të shpalljes së publikuar nga ky institucion. Ai shprehet se, nëse kriteri Master i Shkencave do të kishte qenë i detyrueshëm, ai do të ishte vendosur në mënyrë të shprehur në

¹ Diploma Master Profesional në të Drejtën Penale është lëshuar në datën 08.09.2017;

shpallje dhe ai nuk do të kishte konkurruar për atë pozicion pune. D. T. pretendon gjithashtu se në listën e fituesve janë shpallur persona që disponojnë të njëjtin profil masteri, sikurse ai.

Në nenin 17, germa “b”, të ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” parashikohet se: “Personi që emërohet oficer i Policisë Gjyqësore në seksione duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:b) të ketë përfunduar studimet universitare në një nga institucionet e arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”. Sipas dokumentacionit të depozituar në cilësi prove nga ana e ankuesit, rezulton se ai ka përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare në një nga institucionet e arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, pasi Fakulteti i Shkencave Humane, pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë është IAL që përmbush kriteret e të qënurit i tillë².

Në nenin 4, germa “c”, të Rregullores nr. 21/6, datë 10.06.2020, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë” parashikohet se: “Kandidatët që shfaqin interes për të marrë pjesë në konkurim duhet që brenda afatit të përcaktuar nga Prokurori i Përgjithshëm të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentacionin e kërkuar., i cili duhet të përmbajë:....c) kopjen e diplomës dhe listës së notave, të arsimit të lartë dhe çdo dokument që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”. Në nenin 6, pika 8, germa “a” të Rregullores së sipërcituar përcaktohet se: “Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht: a) Për fazën e parë në të cilën vlerësimi sipas arsimit, përvojës së punës dhe jetëshkrimit, kandidatët mund të marrin deri në 15 pikë, duke ndjekur shkallët e pikëzimit për: i. përvojën në punë mbi 5 vjet; ii. Arsimi përfshirë diplomë pasuniversitare; iii. Vlerësimi i mëparshëm i punës dhe njohuri kompjuterike, gjuhë të huaja dhe kualifikime të tjera.”

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se në asnjë prej akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara nuk rezulton të jetë përcaktuar shprehimisht se Masteri Shkencor është kriter arsimor i detyrueshëm për rekrutimin e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë, por në vlerësim merret parasysh arsimi përfshirë diplomën pasuniversitare, pa përcaktuar nivelin e saj.

Në këto kushte, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (në vijim LMD), parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose

² Referuar dispozitave të Kreut III “Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 1475/1 prot., datë 17.11.2022, Komisioneri i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës³ së sipërcituar, Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 1564/1 prot., datë 22.11.2022, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë njoftimin me nr. prot. 1319, datë 29.09.2022, për shpallje të vendeve vakante për oficer të policisë gjyqësore në disa prokurori të juridiksionit të përgjithshëm. Me datë 15.10.2022, u mbyllën aplikimet dhe rezultoi se ishin 179 kandidatët që shfaqën interesin për të marrë pjesë në konkurim brenda afatit të përcaktuar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe që u dorëzuan pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

Kandidatët për oficer të policisë gjyqësore iu nënshtruan seleksionimit, i cili u krye nga punonjësit e Sektorit të Burimeve Njerëzore, sipas nenit 6, pika 2-7, të Rregullores së Komisionit të Policisë Gjyqësore, nr. 21/6, date 10.06.2020, “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë”.

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1475/2 prot., datë 24.11.2022

Sektori i Burimeve Njerëzore, pas selektimit, vuri në dispozicion Prokurorit të Përgjithshëm dhe Komisionit të ngritur me Urdhër, nr. 76, datë 28.10.2022, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për caktimin e Komisionit të Vlerësimit të aftësive”, listën e kandidatëve, të cilët u përzgjedhën mbi bazën e dokumenteve të paraqitura nga konkurentët, dhe gjetën pasqyrim emrat e konkurentëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 17, të ligjit nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” dhe listën me emrat e kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kriteret dhe shkaqet e skualifikimit.

Kandidatët që nuk u kualifikuan u njoftuan individualisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Kandidatët, që nuk plotësuan kriteret e përcaktuara, Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme i rendit në një listë të veçantë, në të cilën, tregohen dhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kriterëve. Lista administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, kandidatët që nuk janë kualifikuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë Komisionit të Vlerësimit.

Lidhur me pretendimin se D. T. se nuk ka pasur informacion për një kohë të gjatë, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme u theksua se: “Pas mbylljes së afatit të aplikimit, Sektori i Burimeve Njerëzore ka verifikuar dokumentacionin e 179 kandidatëve. Me datë 31.10.2022 nga ana e tyre u njoftuan me telefon 30 aplikant që nuk plotësonin kriteret ligjore, si ato të vjetërsisë dhe pjesës së arsimimit.

Zoti D. T. u telefonua në numrin e telefonit 069..... numër të cilin kishte vënë në dispozicion në kërkesën e dorëzuar, por dilte i padisponueshem dhe vetëm një ditë me pas në datën 01.11.2022 është komunikuar me email dhe i është shpjeguar dhe ky fakt.

Arsyet e skualifikimit të D. T. të cilat i janë sqaruar me email, janë mosplotësimi i 2 (dy) kriterëve ligjore, si ajo e vjetërsisë dhe arsimimi.

Në librezën e sjellë nga kandidati rezulton se ka filluar punë më 06.11.2017 si asistent ligjor dhe e ka ushtruar këtë detyrë deri më datë 21 .07.2021. Në total 3 vite e 9 muaj vjetërsi.

Në librezë është plotësuar dhe një pozicion pune si (nëpunës zyre) në datat 05.07.2018-20.09.2019 periudhë e cila është e shënuar edhe si asistent avokat.

Së pari, në asnjë rast vjetërsia e punës nuk dublohet pavarësisht se sa detyra mund të kryesh në të njëjtën periudhë kohore dhe së dyti pozicioni (nëpunës zyre) në food & trading shpk, nuk njësohet me përvojën e punës si jurist në institucionet private.

Në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” e konkretisht në nenin 82, pika 2, citohet: “Personat që kanë kryer studimet e integruara në drejtësi, ose në një program të cikilit të dytë të studimeve, të barasvlerëshëm me to, mund të konkurojnë për t’u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, avokatë të shtetit, përmbarues privatë ose shtetërorë, si dhe juristë në administratën shtetërore, qëndrore dhe vendore, pasi të kenë kryer provimin e shtetit në drejtësi.

Gjithashtu masteri shkencor është i domosdoshëm në detyrën e opgj edhe për faktin se paga e këtij funksioni është 60% e pagës së prokurorit. Paga referuese bazë e magjistratit, duhet

llogaritur si shuma e elementit të parë të pagës së Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri. (Paga e grupit sipas lidhjes 2, të VKM-së 187, datë 08.03.2017, në vlerën 14.000 lekë) ...dhe element të tjerë si vjetërsia apo shtesa për pozicion.

Lidhja nr. 2 e ligjit të sipërcituar shpjegon vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar dhe llojin i diplomës.

1- Master i Shkencave. Master i Arteve. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë 14.000 lekë.

2- Master Profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë. 11.000 lekë.

3- Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë 10.000 lekë.

Në Vendimin nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit", vendim i nxjerrë në mbështetje të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", përcaktohet se dosja e personelit ka karakter konfidencial. Personat që kanë të drejtë të njihen me këtë dosje janë: a) i punësuar, të cilit i përket dosja; b) eprori direkt; c) nëpunësit e njësisë së burimeve njerëzore që përgjigjen për mbajtjen dhe sistemin e tyre; ç) titullari i institucionit; d) sekretari i përgjithshëm; dhe intitucionet e tjera të ngarkuara nga ligji, dhe në rastin konkret meqënëse, oficerët e policisë gjyqësore emërohen me ligj të veçantë institucioni i ngarkuar në këtë rast është Komisioni i Policisë Gjyqësore...

Përsa parashtruam më sipër, theksojmë se kandidati D. T. është skualifikuar për mos plotësim kriteresh ligjore. Në lidhje me diskriminimin që pretendon kandidati për shkak të gjendjes arsimore, i duhet shpjeguar se diskriminimi si koncept është trajtimi i padrejtë ose paragjykes i njerëzve dhe grupeve bazuar në karakteristikat të tilla si raca, gjinia etj. qoftë ai arsimor. Skualifikimi për mos plotësimin e kriterëve ligjore në kandidimin e një vendi pune, asesi nuk mund të konceptohet si diskriminim apo paragjykim...".

- 2. Për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 236 prot., datë 09.02.2023 "Njoftim për seancë dëgjimore", Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 15.02.2023.*

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë vetëm të përfaqësuesve të palës ndaj të cilës është drejtuar ankesa, pasi subjekti ankues me anë të e-mail-it datë 14.02.2023, njoftoi Komisionerin për pamundësinë për të marrë pjesë në zhvillimin e saj.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor, të cilat do të shtjellohen në vijim.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë njoftimin me nr. prot. 1319, datë 29.09.2022, për shpallje të vendeve vakante për oficer të policisë gjyqësore në disa prokurori të juridiksionit të përgjithshëm.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësoj kandidati për pozicionin e mësipërm, janë si vijon:

- a. *Kërkesën për t'u emëruar oficer i policisë gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore, ku është shpallur vendi vakant.*
- b. *Jetëshkrimin e detajuar të kandidatit.*
- c. *Kopjen e diplomës dhe listës së notave, të arsimit të lartë dhe çdo dokument që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.*
- d. *Librezën e punës ose çdo dokument tjetër që vërteton përvojën në punë të kandidatit si jurist në institucionet publike, private ose profesionet e lira ose në fushën e specialitetit të kërkuar ose si oficer i policisë gjyqësore në shërbimet e policisë gjyqësore (mbi 5 vjet).*
- e. *Vlerësime të mëparshme të punës.*
- f. *Dëshmi të gjuhëve të huaja dhe dëshmi të trajnimeve që ka kryer (në qoftë se ka).*
- g. *Dëshmi penaliteti që tregon se kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe vërtetime nga gjykata dhe prokuroria që vërtetojnë se nuk është në ndjekje penale apo gjykim për kryerjen e ndonjë vepre penale.*
- h. *Dokument që vërteton se ndaj kandidatit nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore dhe se në momentin e konkurimit nuk ka filluar procedim disiplinor ndaj tij.*

Konkurimi zhvillohet në dy etapa:

Pas vlerësimit paraprak të kryer nga Sektori i Burimeve Njerëzore, kandidatët e kualifikuar, i nënshtrohen vlerësimit nëpërmjet testimit profesional. Vlerësimi i kandidatëve nëpërmjet testimit profesional kalon në tre faza nëpërmjet një procesi pikëzimi dhe përfshin:

- a. *Faza e parë, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës në punë e të trajnimeve të lidhura me fushën;*
- b. *Faza e dytë, Vlerësimi me shkrim;*
- c. *Faza e tretë, Intervista e strukturuar me gojë.*

Referuar shpalljes së publikuar, përmes e-mail-eve më datë 06.10.2022 dhe datë 10.10.2022, ankuesi D. T. ka aplikuar për një nga pozicionet vakante për oficer të policisë gjyqësore pranë seksioneve të prokurorive të shkallës së parë.

Mbështetur në informacionin e administruar dhe njoftimit nr. prot. 1319, datë 29.09.2022, për shpallje të vendeve vakante për oficer të policisë gjyqësore në disa prokurori të juridiksionit të

përgjithshëm, kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë brenda 15 ditëve nga momenti i shpalljes së njoftimit.

Më datë 15.10.2022, janë mbyllur aplikimet për vendet vakante për oficer të policisë gjyqësore, ku kishin shprehur interesin 179 kandidatë.

Në Nenin 6, të Rregullores Nr. 21/6, datë 10.06.2020 “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Prokurorisë”, ku citohet procedura e konkurimit, parashikohet se: “

2. Konkurimi zhvillohet në dy etapa:

a. Verifikimi paraprak, i cili, ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të përcaktuara në nenin 17 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” dhe të publikuara në shpalljen për konkurim.

b. Vlerësimi i kandidatëve.

3. Verifikimi paraprak bëhet mbi bazën e dokumenteve (fotokopje) të paraqitura nga kandidatët dhe kryhet nga Sektori i Burimeve Njerëzore, në Prokurorinë e Përgjithshme, brenda 15 ditëve nga data e mbylljes së pranimit të dokumenteve.

4. Pas përfundimit të vlerësimit paraprak, Sektori i Burimeve Njerëzore, harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 17 i ligjit 25/2019 ‘Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore’. Renditja në listë bëhet sipas rendit alfabetik dhe i dorëzohet Komisionit të Vlerësimit të Aftësive.

5. Lista me kandidatët e kualifikuar shpallet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme si dhe afishohet në ambientet e brendshme, të dukshme të këtij institucioni.

6. Kandidatët, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurim, Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme i rendit në një listë të veçantë, në të cilën, tregohen dhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kriterëve. Lista administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

7. Pas vlerësimit paraprak të kryer nga Sektori i Burimeve Njerëzore, kandidatët e kualifikuar, i nënshtrohen vlerësimit nëpërmjet testimit profesional. Vlerësimi i kandidatëve nëpërmjet testimit profesional kalon në tre faza nëpërmjet një procesi pikëzimi dhe përfshin:

a. Faza e parë, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës në punë e të trajnimeve të lidhura me fushën;

b. Faza e dytë, Vlerësimi me shkrim;

c. Faza e tretë, Intervista e strukturuar me gojë;..”.

Nga informacioni i administruar, kandidatët për oficer të policisë gjyqësore ju nënshtrohen seleksionimit, i cili u krye nga punonjësit e Sektorit të Burimeve Njerëzore, sipas nenit 6, pika 2-7, të Rregullores së Komisionit të Policisë Gjyqësore, nr. 21/6, datë 10.06.2020, “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë”.

Pas vlerësimit, referuar kritereve të publikuara, Sektori i Burimeve Njerëzore, i ka vënë në dispozicion Prokurorit të Përgjithshëm dhe Komisionit të ngritur me Urdhër nr. 76, datë 28.10.2022, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për caktimin e Komisionit të Vlerësimit të aftësive”, listën e kandidatëve, të cilët janë përzgjedhur mbi bazën e dokumentave të paraqitura dhe listën me emrat e kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kritere dhe shkaqet e skualifikimit.

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, kandidatët që nuk u kualifikuan janë njoftuar individualisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme. Referuar korrespondencës së mbajtur ndërmjet ankuesit dhe Sektorit të Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se D. T. më datë 01.11.2022, përmes e-mail-it ka kërkuar informacion lidhur me procedurën e konkurimit për oficer të policisë gjyqësore. Në përgjigje të tij, Prokuroria e Përgjithshme, ka sqaruar ankuesin se ka provuar ta kontaktoj përmes numrit të telefonit të vendosur në dispozicion por ka qenë i padisponueshëm. Gjithashtu, e ka informuar D. T. se nuk është kualifikuar për shkak se nuk plotëson kriterin bazë të arsimit Master Shkencash dhe vjetërsinë në punë 5 vite.

Nga informacioni i administruar, ankuesi ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master Profesional⁴ në të Drejtën Penale në Fakultetin e Shkencave Humane, pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

Në nenin 17, germa “b”, të ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” parashikohet se: “Personi që emërohet oficer i Policisë Gjyqësore në seksione duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme: ...b) të ketë përfunduar studimet universitare në një nga institucionet e arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”. Sipas dokumentacionit të depozituar në cilësi prove nga ana e ankuesit, rezulton se ai ka përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare në një nga institucionet e arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, pasi Fakulteti i Shkencave Humane, pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë është IAL që përmbush kriteret e të qënurit i tillë⁵.

Në nenin 4, germa “c”, të Rregullores nr. 21/6, datë 10.06.2020, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë” parashikohet se: “Kandidatët që shfaqin interes për të marrë pjesë në konkurrim duhet që brenda afatit të përcaktuar nga Prokurori i Përgjithshëm të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentacionin e kërkuar., i cili duhet të përmbajë:c) kopjen e diplomës dhe listës së notave, të arsimit të lartë dhe çdo dokument që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”. Në nenin 6, pika 8, germa “a” të Rregullores së sipërcituar përcaktohet se: “Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen

⁴ Diploma Master Profesional në të Drejtën Penale është lëshuar në datën 08.09.2017;

⁵ Referuar dispozitave të Kreut III “Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

përkatësisht: a) Për fazën e parë në të cilën vlerësimi sipas arsimit, përvojës së punës dhe jetëshkrimit, kandidatët mund të marrin deri në 15 pikë, duke ndjekur shkallët e pikëzimit për: i. përvojën në punë mbi 5 vjet; ii. Arsimi përshirë diplomë pasuniversitare; iii. Vlerësimi i mëparshëm i punës dhe njohuri kompjuterike, gjuhë të huaja dhe kualifikime të tjera.”

Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 82, “Programet e studimit në fushën e drejtësisë”, pika 1 dhe 2, parashikon: “1. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike. 2. Personat që kanë kryer studimet e integruara në drejtësi, ose në një program të ciklit të dytë të studimeve, të barasvlershëm me to, mund të konkurojnë për t’u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, avokatë të shtetit, përmbarues privatë ose shtetërorë, si dhe juristë në administratën shtetërore, qendrore dhe vendore, pasi të kenë kryer provimin e shtetit në drejtësi”.

Neni 73, i ligjit Nr. 80/2015, ku referohen programet e ciklit të parë të studimeve, në pikën 1 parashikon se: “1. Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike”.

Sakaq, Neni 75 i ligjit të sipërcituar, analizon programet e ciklit të dytë të studimeve, ku theksohet: “1. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Të gjitha kriteret dhe modalitetet e fitimit të diplomave “Master i arteve” janë të njëjta me ato për fitimin e diplomës “Master i shkencave”, me ndryshimin që diploma “Master i arteve” lëshohet nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë formime në fushën e arteve.

3. Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në: a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike; b) programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të veterinarisë e të arkitekturës. Këshilli i Ministrave përcakton fusha të tjera, në të cilat mund të ofrohen programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

4. Programet e studimit “Master i arteve” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, në fushën e arteve. Këto programe realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike.

5. Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimit të kryer.

6. Programet e studimeve “Master profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe

kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” përmbillen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer”.

Sa më sipër, legjislacioni dhe aktet e analizuara parashikojnë se personi që emërohet oficer i policisë gjyqësore, një ndër kriteret që ai duhet të përmbushë ai i arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë. Ligji për arsimin e lartë referon se personat që kanë kryer studimet e integruara në drejtësi, ose në një program të ciklit të dytë të studimeve, të barasvlershëm me to, mund të konkurrojnë për t’u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë apo juristë në administratën shtetërore, qendrore dhe vendore, pasi të kenë kryer provimin e shtetit në drejtësi. Gjithashtu, studimet e integruara në drejtësi, ose programet e ciklit të dytë të studimeve, të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë janë ato programe të studimeve të ciklit, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike.

Nga provat e administruara rezulton se subjekti ankues, ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master Profesional në të Drejtën Penale. Në këtë kuptim dhe në referencë të parashikimeve ligjore të sipërcituara (neni 73, pika 1 dhe 75, pika 6), ankuesi ka përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor me kohëzgjatje tre vite dhe 180 kredite, si dhe ciklin e dytë Master Profesional me kohëzgjatje dy vite dhe 90 kredite. Në këtë kuptim, ankuesi nuk përmbush kriterin ligjor ku parashikohet se personi që emërohet oficer i policisë gjyqësore, të ketë përfunduar arsimin e lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, që lidhet me përfundimin e studimeve të integruara në drejtësi (*që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike*), ose në një program të ciklit të dytë të studimeve, të barasvlershëm me to (*përfundimi i studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master i Shkencave*).

Pra, në analizë përse më lartë, ankuesi nuk është kualifikuar për në fazën e dytë të konkurimit me shkrim për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor dhe për këtë është njoftuar nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme.

Një ndër shkaqet e skualifikimit të D. T. për në fazën e dytë të konkurimit për vendet vakante për oficer të policisë gjyqësore, është edhe fakti që ai nuk plotëson kriterin e vjetërsisë në punë, 5 vite.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se ankuesi në jetëshkrimin e detajuar ka referuar se:

- Për periudhën 06.11.2017-02.11.2018, ka mbajtur pozicionin Asistent Ligjor, pranë MCA (periudhë 1 vjeçare);
- Për periudhën 02.11.2018-10.02.2021, ka mbajtur pozicionin Asistent Ligjor, pranë ADCA (periudhë rreth 2 vite e 4 muaj);
- Për periudhën 08.2018-09.2019, ka mbajtur pozicionin Asistent Ligjor, pranë Avokat A. Z. (periudhë rreth 1 vit);

- Për periudhën 04.07.2018-20.09.2019, ka mbajtur pozicionin Punonjës Zyre, pranë Food e Trading sh.p.k. (periudhë rreth 1 vit e 2 muaj);
- Për periudhën 03.02.2021-21.07.2021, ka mbajtur pozicionin Jurist, pranë Final sh.p.k. (periudhë rreth 5 muaj);

Sakaq, referuar Librezës së Punës rezulton se ankuesi ka qenë në marrëdhënie punësimi në periudhat si më poshtë:

- Për periudhën 06.11.2017-02.11.2018, ka mbajtur pozicionin Asistent Ligjor, pranë MCA (periudhë 1 vjeçare);
- Për periudhën 02.11.2018-10.02.2021, ka mbajtur pozicionin Asistent Ligjor, pranë ADCA (periudhë rreth 2 vite e 4 muaj);
- Për periudhën 04.07.2018-20.09.2019, ka mbajtur pozicionin Punonjës Zyre, pranë Food e Trading sh.p.k. (periudhë rreth 1 vit e 2 muaj);
- Për periudhën 03.02.2021-21.07.2021, ka mbajtur pozicionin Jurist, pranë Final sh.p.k. (periudhë rreth 5 muaj);

Përsa më lart, referuar jetëshkrimit të depozituar gjatë aplikimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ankuesi rezulton se ka rreth 5 vite e 11 muaj eksperiencë apo vjetërsi pune. Referuar librezës së punës ankuesi ka rreth 4 vite e 11 muaj vjetërsi në punë. Ndërsa, referuar dokumentacionit të paraqitur për konkurim, ankuesi ka rreth 4 vite e 9 muaj përvojë pune në profesion si jurist.

Subjekti ankues, referuar pretendimeve drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, ka kundërshtuar përlllogaritjen e bërë prej tyre sa i përket përvojës në profesion, me pretendimin se nga ana e tyre nuk i është njohur si vjetërsi në punë periudha e stazhit 1-vjeçar në formë internshipi e kryer pranë një avokati.

Neni 20, i ligjit Nr. 55/2018 “Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, parashikon në pikën 3 se: “...3. Çdo avokat ose studio avokatie, që plotëson kushtet e pikës 2, të këtij neni, ka të drejtë të pranojë një ose më shumë kandidatë për avokat. Kandidatët për avokat lidhin marrëveshje me avokatin për kryerjen e stazhit 1-vjeçar në formë internshipi. Kandidatët për avokat gjatë periudhës së kryerjes së stazhit nuk përfitojnë pagesë. Avokati ose studioja e avokatisë, pranë së cilës kryhet stazhi, përjashtohen nga detyrimi për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të kandidatit për avokat, gjatë periudhës 1-vjeçare të kryerjes së stazhit. Periudha e stazhit njihet si periudhë vjetërsie në punë.”

Përsa më sipër, në analizë të dokumentacionit, provave dhe fakteve të administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme nuk i është njohur si përvojë pune stazhi 1-vjeçar në formë internshipi që ai kryer pranë një avokati, duke ia përlllogaritur në total vjetësinë 3 vite e 9 muaj, referuar Librezës së Punës. Sakaq, Komisioneri gjykon se mbështetur në sa është provuar më sipër, edhe në rast se nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme do të ishte njohur si përvojë pune stazhi 1-vjeçar në formë internshipi që ai ka kryer pranë një avokati, nuk do të

plotësonte eksperiencën në profesion mbi 5 vite (si kërkesë për kandidimin për oficer të policisë gjyqësore), pasi nga përlllogaritja në total ai plotëson vetëm 4 vite e 9 muaj.

Në analizë të provave të administruara dhe pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, Komisioneri konstatoi se:

- Referuar shpalljes nr. 1319 prot., datë 29.09.2022, të publikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme dhe legjislacionit të analizuar më sipër në këtë vendim, ankuesi nuk plotëson kriterin arsimor si kandidat për pozicionin e oficerit të policisë gjyqësore;
- Pavarësisht faktit që nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme nuk i është njohur si përvojë pune stazhi 1-vjeçar në formë internshipi që ai kryer pranë një avokati, ky fakt nuk ka cënuar ankuesin nga e drejta për tu kualifikuar si kandidat për pozicionin e oficerit të policisë gjyqësore;

Për sa më sipër, pas analizës së të gjithë fakteve dhe provave në këtë proces shqyrtimi administrativ të ankesës nr. 173, datë 11.11.2022, të D. T., Komisioneri gjykon se Prokuroria e Përgjithshme, nuk e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues, sa i përket procedurave të konkurimit për pozicionet vakante për oficer të policisë gjyqësore pranë seksioneve të prokurorive të shkallës së parë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, D. T., për shkakun e pretenduar, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, në fushën e punësimit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore)
(Fusha: Punësim)